

# Java Kulturore e Arabisë Saudite

## 16-20 Shtator



Java **Kulturore**  
e Arabisë Saudite

**E hapur për publikun**  
16 Shtator | 13:00

# 16-20 Shtator

**ORA: 13:00-20:00**

**PALLATI I KONGRESEVE, TIRANË**



## PAVIJONI I SHKËMBIMIT KULTUROR

Pavijoni i Shkëmbimit Kulturor ofron një përvojë interaktive që i çon vizitorët në një udhëtim shqisor, duke ndërthurur tingullin, prekjen dhe pamjen. Aktiviteti nxjerr në pah ndërthurjet kulturore midis artit saudit dhe atij shqiptar, duke treguar se si traditat lidhen dhe pasqyrojnë identitete të përbashkëta.



## TENDË TRADICIONALE

Majlisi tradicional saudit, i njohur dhe i regjistruar nga UNESCO për rëndësinë e tij historike dhe kulturore, ku vizitorët priten në çadrën e trashëgimisë gjatë Javës Kulturore Saudite në Shqipëri me hurma dhe kafe saudite. Aty ata mund të shijojnë një atmosferë autentike saudite, si dhe të bëjnë foto për kujtim.



## ARTI I KULINARISË

Gjatë Javës Kulturore Saudite në Shqipëri, kuzhina tradicionale saudite u ofron vizitorëve një shije të trashëgimisë kulinare të Mbretërisë nga të 13 rajonet e saj. Do të serviren pjata të ndryshme si: Jareesh, Haneeth, Vegetable Mutabaq, Kleija, Kobaibat Hail si dhe pije karakteristike si Hibiscus - Loomi Mocktail dhe Taif Rose Lemonade.

Java **Kulturore**  
e Arabisë Saudite

# 16-20 Shtator

ORA: 13:00-20:00

PALLATI I KONGRESEVE, TIRANË



## KËNDET E PUNIMEVE ARTIZANALE

Hapësira e mjeshtërive saudite shërben si një zonë interaktive ku artizanët sauditë prezantojnë mjeshtërinë e tyre para publikut shqiptar. Vizitorët kanë mundësinë të shohin nga afër procesin e krijimit, të mësojnë mbi teknikat tradicionale dhe të kuptojnë trashëgiminë e pasur kulturore që përcillet përmes punimeve artizanale.

## VITI I PUNIMEVE ARTIZANALE

Punimet artizanale mishërojnë një autenticitet të prekshëm, të trashëguar brez pas brezi, nga etërit tek gjyshërit. Ato endin një tapiceri historik që lidhin të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Këto punime shprehin trashëgiminë kulturore përmes duarve të afta të mjeshtërive artizanë, të cilët krijojnë, endin, tjerin dhe gdhendin çdo vepër. Çdo objekt mbart vlera trashëgimore, artistike, estetike dhe praktike, të ndërlidhura ngushtë me jetën tonë të përditshme. Gjenialiteti i këtyre mjeshtërive pasqyron kreativitetin dhe mjeshtërinë e sauditëve, duke u harmonizuar me lëndët e para dhe elementët e mjedisit të tyre vendas. Në njohje të këtij misioni fisnik dhe për të ruajtur kuptimin e thellë të punimeve artizanale, duke promovuar njëkohësisht kulturën saudite si në nivel vendas, ashtu edhe global, viti 2025 është shpallur Viti i Punimeve Artizanale.

# Java **Kulturore** e Arabisë Saudite

## 16–20 Shtator

ORA: 13:00–20:00

PALLATI I KONGRESEVE, TIRANË



### EKSPOZITA KULTURORE

#### **Ekspozita e Replikave Antike**

Ekspozita tregon replika që u ofrojnë vizitorëve një përvojë kulturore për të eksploruar trashëgiminë e Mbretërisë.

#### **Moda Saudite**

Ekspozita e Modës Saudite bashkon dizajnerët kryesorë sauditë, duke prezantuar evoluimin e industrisë së modës në Mbretëri.

#### **Dorëshkrime të Rralla Arabe**

Pavijoni i Dorëshkrimeve të Rralla Arabe përmban dorëshkrime digjitale, duke ofruar një ekran interaktiv për të eksploruar thesaret e dorëshkrimeve arabe përmes një përzierjeje të traditës dhe teknologjisë.

#### **Instrumente Muzikore**

Një ekspozitë e instrumenteve muzikore saudite, që shtrihet nga artet tradicionale muzikore deri tek inovacionet moderne, prezantohet nëpërmjet ekraneve interaktive për të siguruar një përvojë të pasur për publikun shqiptar.

#### **Pavijoni i Letërsisë Saudite**

Një hapësirë e dedikuar që ekspozon botimet saudite në arabisht dhe anglisht, përfshirë tregime të shkurtra dhe romane që pasqyrojnë zhvillimin dhe diversitetin e letërsisë saudite. Pavijoni gjithashtu organizon diskutime paneli me shkrimtarë ndërkombëtarë dhe vendas, dhe përmban një seksion të dedikuar për Qytetin Kreativ të Letërsisë të UNESCO-s – Al Taif.

# Java **Kulturore** e Arabisë Saudite

## 16-20 Shtator

ORA: 13:00-20:00

PALLATI I KONGRESEVE, TIRANË



### PAVIJONI I KALIGRAFISË ARABE

Një pavijon i dedikuar për të festuar kaligrafinë arabe, ku ekspozohen veglat tradicionale dhe mbahen demonstrime të drejtpërdrejta nga kaligrafë sauditë dhe shqiptarë.

### AKTIVITETE MUZIKORE

Një gamë e gjerë performancash dhe diskutimesh nxjerr në pah trashëgiminë muzikore të Arabisë Saudite dhe nxit shkëmbimin kulturor me Shqipërinë.

**Saudi Trouq Takon Botën**

Një performancë ndërkulturore që bashkon gjashtë muzikantë sauditë dhe gjashtë shqiptarë. Ansambli ndërthur instrumente saudite si oud, qanun, simsimiyya dhe perkusion me violinë, kitarë, flaut, kontrabas, saksofon dhe bateri. Iniciativa krijon dialog midis traditave, duke shfaqur ritme të përbashkëta dhe veçoritë unike të secilës kulturë, ndërsa nxit bashkëpunimin përmes performancave dhe punëtorive të drejtpërdrejta.

**Diskutim Paneli Muzikor**

"Ruajtja dhe Dokumentimi i Trashëgimisë Muzikore në Arabinë Saudite dhe Shqipëri - Përpyjekjet e së Kaluarës dhe të Tashmes." I planifikuar për 18 shtator, paneli do të eksplorojë trashëgiminë muzikore si një element jetik i trashëgimisë kulturore jo-materiale në të dy vendet, duke përfshirë përpyjekjet për ruajtje, iniciativat bashkëkohore dhe ndikimin e trashëgimisë mbi muzikën e sotme. Folësit përfshijnë Omar Ibrahim, me moderimin e Namar Tarabzoni, dhe pjesëmarrje nga pala shqiptare.

**Shfaqja e Muzikës Moderne**

Duke prezantuar Ana.n7n, një bandë e pavarur nga Xheddah, e njohur për ndërthurjen e muzikës rock me tekste në arabisht vernakulare. E themeluar në vitin 2019, banda ka zhvilluar një stil të veçantë që pasqyron ndikime globale dhe identitetin saudit. Performanca e tyre bashkëkohore nxjerr në pah energjinë krijuese të skenës moderne muzikore saudite dhe ofron një perspektivë të re për audiencën.

**Koncert Muzikor**

# Java **Kulturore** e Arabisë Saudite

## 16-20 Shtator

ORA: 13:00-20:00

PALLATI I KONGRESEVE, TIRANË



### PERFORMANCA TEATRALE

Si pjesë e Javës Kulturore Saudite në Shqipëri, një përzgjedhje e artit tradicional performues saudit do të prezantohet në skenë. Këto shfaqje të drejtpërdrejta nxjerrin në pah trashëgiminë popullore dhe diversitetin muzikor të Mbretërisë së Arabisë Saudite, duke i dhënë audiencës mundësinë të përjetojë shprehje të veçanta kulturore të ruajtura brez pas brezi.

**Daq al-Hab**

Një art ritmik nga komunitetet bujqësore, i interpretuar gjatë bluarjes së drithërave me mjete druri, këngë dhe lëvizje rrethore.

**Al-Heidah**

Nga Rajoni Lindor, duke përfshirë dy rreshta përballë njëri-tjetrit të udhëhequr nga vargjet e një poeti.

**Al-Hand**

Një art tradicional i interpretuar nga gratë në rajonin Najd, i karakterizuar nga lëvizjet e flokëve dhe trupit në harmoni me daullet dhe ritmet muzikore.

**Al-Fareesa**

Krijuar që nga epoka Abaside, ku një interpretues realizon skena me kalërim brenda një kornize prej gjetheve të palmës, i shoqëruar nga daullet dhe tamburët.

**Al-Tanboora**

Një art kolektiv për meshkuj dhe femra, që kombinon instrumentin tanboora me brezin manjūr për të krijuar tinguj ritmikë të veçantë.

Java **Kulturore**  
e Arabisë Saudite

# 16-20 Shtator

ORA: 13:00-20:00

PALLATI I KONGRESEVE, TIRANË



## FILMA ME METRAZH TË SHKURTËR

Si pjesë e Javës Kulturore Saudite në Shqipëri, do të shfaqet një përzgjedhje filmash me metrazh të shkurtër sauditë për të nxjerrë në pah krijimtarinë në rritje kinematografike dhe tregimin e historive të Mbretërisë. Programi përfshin tituj si: The Journey, Me & Idros, The Pond, Saleeq, Saeed, Ball, Old School, dhe Monsters in the Sky. Së bashku, këto vepra tregojnë diversitetin e zërave dhe temave që eksplorojnë nga regjisorët e rinj sauditë, duke u ofruar audiencës një vështrim mbi kinemanë bashkëkohore saudite.

## PANELET E LETËRSISË

Një seri panelesh do të eksplorojë letërsinë saudite të përkthyer dhe ndërthurjet e saj me kulturën shqiptare. Përmes diskutimeve dhe leximeve të drejtpërdrejta, sesionet nxjerrin në pah rolin e përkthimit në lidhjen e shoqërive dhe sjelljen e zërave sauditë tek audienca të reja.

Panelet mbi Veprat Saudite në Përkthim

Diskutime mbi procesin e përkthimit dhe leximet nga veprat I Stopped Crying, The Najdi Boy's Journey (në shqip), Al-Warfa, Man Chased by Crows, dhe The Critical State of Mr. K.

Ura e Tregimeve: Ndërthurjet e Narrativave Popullore midis Gjirit dhe Ballkanit

Eksploron paralelizmat midis narrativave popullore në të dy rajonet—strukturat, personazhet dhe simbolikën e tyre—duke marrë parasysh evolucionin e tyre nga tradita e rrëfimeve popullore në letërsinë e shkruar dhe ndikimin e tyre në shprehjen bashkëkohore.

Përvoja e Mbikëqyrjes së Përkthimit të Librave Saudite në Shqipëri Reflekton mbi procesin e përkthimit të veprave saudite në shqip, sfidat dhe njohuritë e fituara, si dhe pritshmërinë e këtyre veprave pas publikimit.





Java  
**Kulturore e**

Kalendari i aktiviteteve  
*kulturore dhe artistike*

# ARABISË SAUDITE

Salla e Koncerteve,  
PALLATI I KONGRESEVE

# E martë 16/09

---

Tryezë : “Ndalova së  
vajtuari” 2:00 – 3:00 PM

“Trouq takohet me  
botën” 3:00 – 3:30 PM

Shfaqje teatrore 4:20 – 5:15 PM

Filma të shkurtër  
(Al-Rihla,  
Ana Wa Al-  
Aidrous, Hawdh) 5:15 – 5:45 PM

Fjalimi i Ambasadorit  
të Mbretërisë së  
Arabisë Saudite 6:35 – 6:40 PM

Fjalimi i Ministrit  
të Kulturës, Turizmit  
dhe Sporteve 6:40 – 6:45 PM

Shfaqja e Hapjes  
• Video  
• “Trouq takohet me  
botën”  
• Shfaqje teatrore 6:45 – 7:15 PM



# E mërkurë 17/09

---

Diskutim rreth librit  
"Al-Warfa" 1:30 – 2:30 PM

Diskutim rreth librit  
"Udhëtimi i djaloshit  
najdi" (Shqip) 2:30 – 3:30 PM

"Trouq takohet me  
botën" 3:30 – 4:30 PM

Shfaqje teatrore 4:30 – 5:30 PM

Filma të shkurtër  
(Salik, Saeed,  
Wuhoush Fe Sama) 5:30 – 6:00 PM

Shfaqje teatrore 6:00 – 7:00 PM

Performancë  
bashkëkohore 7:00 – 8:00 PM



# E enjte 18/09

---

Urat e Historive:  
Kryqëzimet e  
Narrativave  
Popullore midis  
Gjirit dhe Ballkanit

2:30 - 3:30 PM

Simpozium për  
muzikën

3:30 - 4:30 PM

“Trouq takohet me  
botën”

4:40 - 5:10 PM

Shfaqje teatrore

5:20 - 5:50 PM

Filma të shkurtër  
(Salik, Saeed,  
Wuhoush Fe Sama)

6:00 - 6:30 PM

“Trouq takohet me  
botën”

6:30 - 7:00 PM

Shfaqje teatrore

7:10 - 7:50 PM



## E premte 19/09

---

Njeriu i ndjekur  
nga korbat

2:15 - 3:15 PM

"Gjendja kritike e të  
ftuarit K"

3:15 - 4:15 PM

"Trouq takohet me  
botën"

4:25 - 4:55 PM

Shfaqje teatrore

5:00 - 5:40 PM

Filma të shkurtër  
(Kura, Al-Madrasah  
Al-Kademah, Hawdh,  
Ana wa Aidrous,  
Wahsh Men Al-Sama)

5:40 - 6:00 PM

"Trouq takohet me  
botën"

6:10 - 6:50 PM

Shfaqje teatrore

7:10 - 8:00 PM

سليق Saleeg

فلم افنان باويان Film by Afnan Bawyan

# E shtunë 20/09

---

Diskutim: Përvoja  
e përkthimit  
të librave saudite  
në shqip

2:00 – 3:00 PM

Filma të shkurtër  
(Salik, Al-Rihla,  
Saeed, Hawdh, Kura)

3:00 – 3:30 PM

“Trouq takohet me  
botën”

3:40 – 4:10 PM

Shfaqje teatrore

4:25 – 5:05 PM

Filma të shkurtër  
(Salik, Al-Rihla,  
Saeed, Hawdh, Kura)

5:15 – 5:45 PM

Ceremonia  
përmbyllëse

7:00 – 8:15 PM

